Aktualitet

U qëllua me armë sa doli nga shtëpia në Vlorë/ 27 vjeçari telefonoi policinë, identifikohet automjeti i autorëve: S'kam asnjë konflikt, s'pashë kush më qëlloi

Burime bëjnë me dije se dy persona kanë ruajtur 27 vjeçarin në banesë dhe pasi ka dalë nga shtëpia, kanë qëlluar me armë në drejtim të tij, por fatmirësisht ka shpëtuar pa lëndime.

Sh.com
Redaksia
20 Tetor, 07:41 | Përditesimi i fundit: 20 Tetor, 15:38

VLORË- Policia ka marrë një telefonatë nga 27 vjeçari ***Mero Ferraj,*** banues në Vlorë, i cili ka kallzuar se në lagjen Partizani, një person ende i pa identifikuar, që qarkullonte me një automjet dyshohet se ka qëlluar me pistoletë në drejtim të tij por pa i shkaktuar dëmtime atij dhe as kalimtarëve të rastit.

Burime bëjnë me dije se dy persona kanë ruajtur personin në banesë dhe më pas 27 vjeçari ka tentuar që të dalë nga shtëpia. Sapo ka dalë Ferraj, një automjet ka qëndruar para shtëpisë dhe ka nisur që të qëllojë me armë.

Sh.com
LEXO EDHE:
'Gaxhait' të Vlorës, i shtohet një dënim me 1 vit burg, për futjen e telefonit në qeli

Fatmirësisht ka pasur vetëm dëmtime materiale tek një makinë tip "Polo", ku plumbat i kanë thyer xhamat. Në vendngjarje janë gjetur 2 gëzhoja, teksa 27-vjeçarit Mero Ferraj ka deklaruar se nuk ka konflikt me asnjë dhe se nuk i ka njohur personat që e kanë qëlluar.

Dyshohet se 27 vjeçari, i cili është nipi i një biznesmeni të ndërtimit është monitoruar dhe më pas i kanë bërë pritë.

Burime për Report TV, bëjnë me dije se kamerat e banesës kanë filmuar automjetin e autorëve. Policia ka ngritur pika kontrolli dhe po vëzhgohen kamerat, si dhe po vijon krehja e zonës. Grupi hetimor po vijon punën për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

Banesa dhe policia ne vendngjarje

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:55

Detaje nga atentati në Vlorë/ Zbardhet dëshmia e 27-vjeçarit: S'kam asnjë konflik, s'pashë kush më qëlloi

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga atentatit mbrëmjen e djeshme në lagjen "Partizani". Në vendngjarje janë gjetur 2 gëzhoja, teksa 27-vjeçarit Mero Ferraj ka deklaruar se nuk ka konflikt me asnjë dhe se nuk i ka njohur personat që e kanë qëlluar.

D.P./B.K./Shqiptarja.com
TAG: Vlore tentative per vrasje

Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM
Sondazhi i ditës:
'Kush prek votën t'i pritet dora' , a e mbështesni propozimin e Presidentit Meta?
PO JO NUK KAM MENDIM
Komento

Komente

O pasha o mbret: 20/10/2020 18:20
Ky e ka inskenuar vet, ka nerezit e tij ne amerik dhe do te iki vet, para tre vjetesh dogji dhe makinen gjasme ja dogjen. Eshte i talentuar kania
Përgjigju

prengaNY: 20/10/2020 08:27
kaja mor içatnon, ka marr fund içaj ven. e kan pushtue hajvanat me kravat e spinelat me q7. asht bo alltija si cakmak, e mbajn tan nxhep.
Përgjigju

MINUTË PAS MINUTË
19:40 Sindikata ndërkombëtare letër Ramës për naftëtërët: Të ndërhyjë sa më shpejt për të siguruar pagat e prapambetura
19:15 Meta për 75-vjetorin e OKB-së: Është gurthemeli i bashkëpunimit shumëpalësh! Anëtarësimi i Kosovës, faktor i rëndësishëm i stabilitetit në rajon
18:54 Jo vetëm gjoba! Polici në Fier i dhuron maskën qytetarit i cili nuk e kishte (VIDEO)
18:42 KPA e rikthen në detyrë, Vjerdha: 6000 qytetarë firmosën një peticion për kthimin tim! E mbështes sërish vettingun
18:29 Rama takim me kryeministrin e Sllovenisë: Diskutime mbi planin e investimeve të BE në Ballkanin Perëndimor
HOROSKOPI
Me te lexuarat e dites Me te lexuarat e javes
Lajme Fotogaleri Videogaleri
1. Puthje e përqafime në pandemi! Monika Kryemadhi takim me të rinjtë e LRI si gjithmonë pa maska
2. 'Unaza e Madhe'/ Të hënën nis devijimi i trafikut...si do ndryshojë lëvizja e makinave për 4 muajt e ardhshëm (VIDEO)
3. Lul Berisha merr fitoren e dytë me shtetin! Gjykata i kthen licencat e 1.2 mln litra naftë të 'Rajan 2007'
4. Ekskluzive/ Skandali i Metës me nënshtetësinë alarmoi Brukselin, KE ndërhyri për të ndaluar dhënien e pasaportave pa protokolle sigurie
5. Vijon numri i lartë i të infektuarve/ 302 raste të reja me COVID dhe 4 viktima në 24 orë! Rekord infektimesh në Tiranë
6. U la jashtë listës/ Baçi për Report Tv: Unë e kam kontratën me PD dhe strukturat që më kanë votuar në mënyrë plebishitare!
7. Me maska dhe flamurin grek/ Familja përkujton Konstandinos Kacifas në një ceremoni private: Po na helmojnë grekët dhe shqiptarët, ne duam drejtësi
8. Virologu italian, jepni fund histerisë, 95 % e të infektuarve me Covid-19 janë asimptomatikë
9. Do krijojë parti të re për zgjedhjet e 25 prillit? Topalli për Report TV mohon zërat: Jo, nuk është e vërtetë
10. Nuk ishte në listën e kandidatëve për deputet të PD-së, Sarandë, Tahiri: Do jem në Parlament e do përfaqësoj dinjitetin çam

Lajme të tjera

Aktualitet

Jo vetëm gjoba! Polici në Fier i dhuron maskën qytetarit i cili nuk e kishte (VIDEO)
24 Tetor, 18:51

Aktualitet

KPA e rikthen në detyrë, Vjerdha: 6000 qytetarë firmosën një peticion për kthimin tim! E mbështes sërish vettingun
24 Tetor, 18:39

Aktualitet

Dyshohet për shkëndijë elektrike, makina bëhet shkrumb nga flakët në aksin Levan-Vlorë (VIDEO)
24 Tetor, 18:13

Aktualitet

Erozioni detar po zhduk Kunen në Shëngjin, banorët: Brenda pak vitesh do përmbytet, s'do ekzistojë më
24 Tetor, 18:03

Aktualitet

Vëzhgimi i Report Tv/ Të moshuarit më të bindur për maskën! Në Tiranë shumë të rinj neglizhojnë
Doris Sallaku
24 Tetor, 16:45

Aktualitet

Vijon numri i lartë i të infektuarve/ 302 raste të reja me COVID dhe 4 viktima në 24 orë! Rekord infektimesh në Tiranë
24 Tetor, 15:59

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje